



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/201
Datë 23.06.2020

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 08.06.2020 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Validohet dhe akreditohet Qendra e Kompetencës në Prizren me adresë, Ish Kazerma TMK-së, Dardani Prizren, për periudhën tri vjeçare 01.09.2020 deri 01.09.2023 me kualifikimet:
 - 1.1. **Asistent në zyra të informimit dhe agjenci turistike, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP**
 - 1.2. **Menaxhim dhe planifikim i ngjarjeve, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP**
 - 1.3. **Nëpunës financiar, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP**
 - 1.4. **Nëpunës industrial, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP**
 - 1.5. **Nëpunës referent i kuadrove, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP**
 - 1.6. **Udhëheqës i grupit turistik, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP**


A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Rivalidimin e kualifikimit, Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Riakreditimin e institucionit, i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime, janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Rivalidim të kualifikimit/modulit; Aplikacioni për Riakreditim si institucion ofrues dhe/ose Vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

2. Vendimi u dërgohet:

- Qendrës së Kompetencës në Prizren
- Arkivit të AKK


Kryetarja e KD së AKK-së
Violeta Dema

